



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

RELACION SHPJEGUES

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

***Qëllimi 1** – Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykate, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.*

Ky qëllim është përmbushur në masën 100%.

Në realizimin e plotë të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetësuese për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur tre objektiva për realizim, si më poshtë:

1. **Objektivi 1.1** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja të 34 fëmijëve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022. Gjithashtu 1 fëmijë është revokuar për 2021 dhe procedurat kanë zgjatur deri në vitin 2022. ***Ky objektivi është përmbushur plotësisht.*** Gjatë periudhës raportuese, KSHB ka shqyrtuar brenda afateve ligjore të gjitha kërkesat për birësim.
2. **Objektivi 1.2** – Blerje pajisje elektronike. ***Ky objektivi është realizuar 100%***, është realizuar blerja e pajisjes elektronike – Kompjuter Desktop, 1 (një) copë, është marrë malli në dorëzim. Për këtë procedurë është në bërë likuidimi.
3. **Objektivi 1.3** – Blerje pajisje zyre. ***Ky objektivi është realizuar 100%***, është realizuar blerja e pajisjeve të zyrës, është marrë malli në dorëzim, si dhe është likuiduar detyrimi sipas faturës.

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objektiv, situata paraqitet si në vijim:

Objektivi 1.1 ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti A – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. *Ky produkt është përmbushur në masën 94%.*

| | |
|---|----|
| Sasia (sipas planit 12/mujor) | 36 |
| Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 35 |
| Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 34 |

| | |
|---|-----------------|
| Shpenzimet (sipas planit12/mujor) | 15.800.000 lekë |
| Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 13.165.000 lekë |
| Shpenzimet faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 10.986.826 lekë |

| | |
|--|--------------|
| Kosto/njësi (sipas planit12/mujor) | 438.889 lekë |
| Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 376.143 lekë |
| Kosto/njësi faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 323.142 lekë |

Shpenzimet për këtë product janë përballuar me fondet e miratuara nga Buxheti I shtetit në fillim të vitit 2022, duke u shtuar me 100.000 lekë nga fondi I veçantë , si dhe duke u pakësuar në masën totale prej 2.735.000 lekë Arsyet e rishikimit të këtyre fondeve janë për shkak se këto fonde nuk arritën të përdoreshin si pasojë e mungesave në personelin e KSHB si dhe të pamundësisë për të ndjekur të plote rregjistrin e prokurimeve .

Objektivi 1.2 ka patur një product të parashikuar .

Produkti B – Pajisje elektronike të blera. *Ky produkt është përmbushur në masën 85 %.*

| | |
|---|---|
| Sasia (sipas planit 12/mujor) | 1 |
| Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 1 |
| Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 1 |

| | |
|---|--------------|
| Shpenzimet (sipas planit12/mujor) | 120.000 lekë |
| Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 120.000 lekë |
| Shpenzimet faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 101.000 lekë |

| | |
|--|--------------|
| Kosto/njësi (sipas planit12/mujor) | 120.000 lekë |
| Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 120.000 lekë |
| Kosto/njësi faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 101.000 lekë |

Objektivi 1.3 ka patur një product të parashikuar .

Produkti C – Pajisje zyre të blera. *Ky produkt është përmbushur në masën 100%.*

| | |
|---|---|
| Sasia (sipas planit 12/mujor) | 2 |
| Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 2 |
| Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 2 |

| | |
|---|-------------|
| Shpenzimet (sipas planit12/mujor) | 80.000 lekë |
| Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 80.000 lekë |
| Shpenzimet faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 73.200 lekë |

| | |
|--|-------------|
| Kosto/njësi (sipas planit12/mujor) | 80.000 lekë |
| Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 80.000 lekë |
| Kosto/njësi faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2022) | 73.200 lekë |

Shpenzimet për këto produkte janë përballuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit në fillim të vitit 2022.

Në përfundim të analizës së realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve të programit, mund të themi se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022. KSHB ka bërë një punë mjaft të mirë për përmbushjen e politikës së programit të vet. Institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur plotësisht qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, si dhe realizimi i proceseve birësuese brenda dhe jashtë vendit duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijëve.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, është monitoruar vazhdimisht buxheti i miratuar dhe në zbatim të pikës 4, të Udhëzimit Plotësues nr.4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, me kërkesë të KSHB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratoi rialokimin e shumës prej 24.000 lekë nga artikulli 602 (Mallra dhe shërbime) në artikullin 606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë). Nga ana tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar fondin e veçantë prej 100.000 lekë për vitin 2022.

Me Aktin Normativ Nr.3/2022, për institucionin tonë janë pakësuar 735.000 lekë, konkretisht: 230.000 lekë nga llogaria 600 (paga), 45.000 lekë nga llogaria 601 (sigurime shoqërore), dhe 460.000 lekë nga llogaria 602 (mallra dhe shërbime). Gjithashtu, me Aktin Normativ Nr.17 dt.01.12.2022, për institucionin tonë janë pakësuar 2.000.000 lekë, konkretisht: 1.000.000 lekë nga llogaria 600 (paga), dhe 1.000.000 lekë nga llogaria 602 (mallra dhe shërbime)..Konkretisht :

• **Artikulli 600 (Pagat)**

| | |
|--------------------------------|----------------|
| Buxheti Fillestar | 9.200.000 lekë |
| Fonde te pakesuara gjate vitit | 1.230.000 lekë |
| Fonde te shtuara gjate vitit | 0 lekë |
| Buxheti i Rishikuar | 7.970.000 leke |

• **Artikulli 601 (Sigurime shoqerore dhe shendetesore)**

| | |
|--------------------------------|----------------|
| Buxheti Fillestar | 1.800.000 lekë |
| Fonde te pakesuara gjate vitit | 45.000 lekë |
| Fonde te shtuara gjate vitit | |
| Buxheti i Rishikuar | 1.755.000 lekë |

Diferencat shpjegohen me strukturen organike të institucionit të paplotesuar gjatë gjithë vitit buxhetor 2022, ku nga 9 pozicione te miratuara, paraqiten vakant disa pozicione.

• **Artikulli 602 (Mallra dhe sherbime të tjera)**

| | |
|--------------------------------|----------------|
| Buxheti Fillestar | 4.600.000 lekë |
| Fonde te pakesuara gjate vitit | 1.460.000 lekë |
| Fonde te shtuara gjate vitit | |
| Buxheti i Rishikuar | 3.140.000 lekë |

Diferencat shpjegohen me uljen e shpenzimeve per honorare bordi, gjë e cila lidhet me pjesemarrjen ne mbledhjet e Keshillit Drejtues, konkretisht: parashikimi 1.200.000 leke / realizimi 584.000 leke (49%), fondi i kursyer eshte 616.000 lekë. Gjithashtu , shpenzimet per shërbime nga të tretet (energji elektrike, uje, telefoni fikse dhe shërbim postar) janë më të ulta krtahasuar me parashikimin , I cili I referohet mesatares së realizimit të viteve të fundit .

• **Artikulli 606 (Transferta të brendshme)**

| | |
|--------------------------------|--------------|
| Buxheti Fillestar | 0 lekë |
| Fonde te pakesuara gjate vitit | |
| Fonde te shtuara gjate vitit | 274.000 lekë |
| Buxheti i Rishikuar | 274.000 lekë |

Nga ky artikull kontabël, fondi i miratuar nga 100.000 lekë nga Fondi i Veçantë nuk është realizuar në masën 100% , pasi nuk kanë ndodhur situatat e parashikuara për përfitimin nga ky fond. Nga ana tjetër, shuma prej 24.000 leke e transferuar nga artikulli 602 Për kompensimin e telefonise celulare të titullarit të institucionit , është realizuar në masen 20.000 leke (90%). Pjesa tjetër prej 150.000 lekësh është përdorur për shpërblimet e punonjësve sipas sipas V.K.M nr.898 dt.29.12.2022.

• **Artikulli 231 (Investime)**

| | |
|--------------------------------|--------------|
| Buxheti Fillestar | 200.000 lekë |
| Fonde te pakesuara gjate vitit | |
| Fonde te shtuara gjate vitit | |
| Buxheti i Rishikuar | 200.000 lekë |

Për këtë artikull kontabël realizimi është në masën 87% .

Realizimi i buxhetit sipas llogarive ekonomike për periudhën raportuese, paraqitet si në vijim:

| | Totali | Llog. 600 | Llog. 601 | Llog. 602 | Llog. 606 | Llog. 231 |
|-------------------------------|---------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Buxheti (PLAN) | 13,165,000 | 7,970,000 | 1,755,000 | 2,966,000 | 274,000 | 200,000 |
| Buxheti (FAKT) | 10,986,826 | 7,005,421 | 1,186,101 | 2,447,104 | 174,000 | 174,200 |
| Përqindja e realizimit | 83.45% | 87.90% | | 82.51% | | 87.10% |

- Diferencat në realizim në llogarinë ekonomike 600 (Paga) dhe 601 (Sigurime shoqërore) vijnë si pasojë e strukturës organike të paplotësuar të institucionit, ku gjatë vitit paraqiten vakant pozicionet: Specialist (Psikolog) – me kategori page IV-a, Specialist (Shkenca sociale) – me kategori page IV-a, si dhe Specialist (Arkiv-Protokoll) – me kategori page IV-b për periudhën Janar-Shtator 2022, Specialist Financë-Buxheti – me kategori page IV-a për periudhën Gusht –Dhjetor 2022 .Gjithashtu nje Specialiste (Psikolog) ka qënë me lejë lindje për periudhën Qershor- Nëntor 2022.
- Sa i takon llogarisë ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) ka diferenca duke qënë se nuk janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit të parashikuara gjatë 12-mujorit të vitit 2022. Nga ana tjetër, edhe fondet e parashikuara për shërbime nga të tretët, si dhe për zërin honorare për anëtarët e Këshillit Drejtues të KSHB nuk janë realizuar në masë të plotë gjatë periudhës raportuese.
- Po ashtu, fondi prej 274.000 lekë miratuar në llogarinë ekonomike 606 (Transferata për buxhete familjare ose individë) është realizuar për pagesën e telefonit të Kryetares së Institucionit dhe për shpërblimet e punonjësve në fund të vitit sipas V.K.M nr.898

dt.29.12.2022 (nuk është realizuar për raste të situatave të vështira, dalje në pension etj). Pjesa tjetër e fodnit prej 100.000 lekë mbetet e papërdorur deri në përfundim të vitit buxhetor .

- Lidhur me fondet e investimeve në llogarinë ekonomike 231 (Investime kapitale të brendshme), është realizuar në masen 87%.
- Janë realizuar të gjitha procedurat për blerjen e një pajisje elektronike dhe për blerjen e 2 karrikeve për zyrat e Institucionit .

Theksojmë se, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fonde nga Buxheti i Shtetit.

Sa i takon treguesve të performancës, situata paraqitet:

Tregues performance në nivel qëllimi:

- 1. Përgjindja e rasteve të birësimeve të sukseshme ndaj totalit të birësimeve** – Parashikimi 100% / Realizimi 100%.

Të gjitha procedurat e birësimit të realizuara brenda dhe jashtë vendit kanë rezultuar të sukseshme dhe përshtatja prind-fëmijë është arritur plotësisht.

Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektiv janë realizuar plotësisht.

Në përfundim, sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar asnjë objekt investimi me financim të huaj. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe si rrjedhojë nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash. Të ardhurat sekondare të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit.

**HARTOI:
SPECIALIST (BUXHET-FINANCË)**

Elda Liçkollari

**MIRATOI:
KRYETAR**

Alma Laci